



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektvendim.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin për ndryshimin e “Rregullores së Brendshme të Kuvendit”, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij propozimi në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

K R Y E T A R I

Lulzim Basha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTVENDIM
Nr. ____/2023

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin numër 116, datë 16.12.2004 “Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas nenit 119 shtohet neni 119/1 me këtë përmbajtje

Neni 119/1

Autorizimi për lejimin

- 1. Autorizimi i parashikuar nga enet 118 dhe 119 të Rregullores nuk është i nevojshëm të jepet në rastin kur Deputeti ka lëshuar autorizim me shkrim për lejimin e ushtrimit të ndjekjes penale, marrjes së masës së sigurimit personal arrest me burg, apo arrest në shtëpi, kontrollin e personit apo të banesës.*
- 2. Brenda 5 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit ose e marrjes së mandatit gjatë legjislaturës, çdo deputet ftohet nga Kryetari i Kuvendit të depozitojë autorizimin për lejimin e e ushtrimit të ndjekjes penale, marrjes së masës së sigurimit personal arrest me burg, apo arrest në shtëpi, kontrollin e personit apo të banesës.*
- 3. Autorizimi i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit, i cili njofton menjëherë Prokurorinë e Përgjithshme dhe Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të organizuar.*
- 4. Autorizimi i dhënë nuk mund të revokohet.*

Neni 2

Dispozitë Kalimtare

- 1. Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Kryetari i Kuvendit fton deputetët të depozitojnë autorizimin për lejimin e e ushtrimit të ndjekjes penale, marrjes së masës së sigurimit personal arrest me burg, apo arrest në shtëpi, kontrollin e personit apo të banesës.*

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA